

Administrata komunale e Komunës Preshevë, Drejtoriatit për urbanizëm planifikimin hapsinor dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, në mbështetje të nenit 50 të Ligjit mbi planifikimin dhe ndërtimin ("Fl.zyrtare e RS", nr. 72/09, 81/09- përmirësim, 64/10- Vendimi i GJK, 24/11, 121/12, 42/13- Vendimi i GJK, 50/13- Vendimi i GJK, 98/13- Vendimi i GJK, 132/14, 145/14, 83/18, 31/19, 37/19- Ligji tjetër, 9/20 dhe 52/21), nenit 55-65 të Rregullores mbi përmbajtjen, mënyrën dhe procedurën e hartimit të dokumenteve të Planifikimit hapsinor dhe urbanistik ("Fl.zyrtare e RS", nr.32/19) dhe nenit 19 të Ligjit mbi vlerësimin strategjik të ndikimit në mjedisin jetësor ("Fl.zyrtare e RS", nr. 135/04 dhe 88/10)

**SHPALL QASJE PUBLIKE**  
**Në Projekt Planin Hapsinor Të Komunës Preshevë**  
**dhe**  
**Raporti mbi vlerësimin strategjik të ndikimit të Planit hapësinor**  
**Të komunës Preshevë në mjedisin jetësor**

Qasja publike në Projekt dokumentet planore dhe raportin mbi vlerësimin strategjik të ndikimit në mjedisin jetësor (në tekstin vijues: Dokumentacioni planor) do të kryhet në kohëzgjatje prej 30 ditësh, duke filluar prej 22.11.2021 v., duke përfunduar më 22.12.2021 v.

Dokumentacioni planor do të jetë i paraqitur çdo ditë pune prej ora 07 deri në ora 15,00 në ndërtesën e Administratës komunale të komunës Preshevë, 17523 Preshevë, rruga Marshal Tita nr. 36, në koridorin- përdhesë, si dhe në faqen e internetit Komuna e Preshevës ([www.presevo.rs](http://www.presevo.rs)).

Personave të interesuar juridik dhe fizik, të cilët do të kenë qasje në dokumentacionin planor të paraqitur, Drejtoriatit për urbanizëm, planifikimin hapsinor dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, do ti ofron të gjitha informacionet e duhura dhe ndihmën profesionale. Informacionet shtesë mund të merren çdo ditë pune në hapsirat e Drejtoriatit për urbanizëm, planifikimin hapsinor dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, 17523 Preshevë, rruga Marshal Tito nr. 36 ( zyre nr. 10 në përdhesë). Personi i autorizuar për dhënjen e njoftimeve është Shaban Jashari- kryeshef i Drejtoriatit.

Vërejtjet mund të paraqiten gjatë zgjatjes së qasjes publike, Administratës komunale të komunës Preshevë, Drejtoriatit për urbanizëm, planifikimin hapsinor, dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, 17523 Preshevë, rruga Marshal Tito nr. 36 , personalisht në shkresore ose me postë, përfundimisht më 22.12.2021 v.

Gjatë kohëzgjatjes së qasjes publike, do të mbahet prezentimi publik, më 09.12.2021, duke filluar në ora 12,00, në sallën e Kuvendit në ndërtesën e Administratës komunale të komunës Preshevë.

Pas përfundimit të qasjes publike do të mbahet mbledhja publike e Komisionit për plane 28.12.2021, në hapsirat e Administratës komunale Preshevë, 17523 Preshevë, rruga Marshal Tito nr. 36, në sallën e Kuvendit në ndërtesën e Administratës komunale të komunës Preshevë duke filluar në ora 12,00.

Në mbledhjen e Komisionit për plane mund të merr pjesë çdo person fizik dhe përfaqësues i personit juridik, të cilët kanë paraqitur vërejtje në kohëzgjatjen e qasjes publike.